

AKT I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Primefit” SH.P.K

Sot, më 16/12/2024, në Tiranë, palët e mëposhtme (referuar në tekst kolektivisht si “**Ortakët Themelues**”, ose individualisht secili si “**Ortaku**”) bien dakord të miratojnë Aktin e Themelimit, si më poshtë :

Z. Geri Lulaj, shtetas shqiptar, lindur me 31.01.1997 ne Vlorë e banues ne Vlorë, mbajtës i kartes se identitetit me nr. ID J70131076S, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

I. Themelimi

1. Ortaku themelues vendosi për themelimin e shoqërisë " **Primefit** " Sh.p.k, nje shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar (“**Shoqëria**”).
2. Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në adresën: ***Shqipëri, Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Ismail Qemali, Pallati 34, Kati i 2.***
3. Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pacaktuar.

II. Objekti

1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:

Krijimi, zhvillimi dhe administrimi i një platforme online për tregtimin dhe shpërndarjen e produkteve të kompanisë, përfshirë mundësinë e ofrimit të informacionit për produktet, menaxhimin e porosive dhe transaksioneve, si dhe sigurimin e shërbimeve të mbështetjes për klientët.

Shoqëria do të kryejë çdo veprimtari që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të.

Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standardet më të larta të etikës.

III. Statuti

Ortaku Themelues me anë të kësaj deklaron miratimin e Statutit të Shoqërisë .

IV. Kapitali Themeltar

1. Kapitali fillestar i Shoqërisë është 10,000 (dhjetë mijë) Lekë. Cdo ortak zotëron 1 (një) kuotë me një vlerë të përgjithshme nominale në proporcion me kontributin e cdo ortaku në kapitalin e Shoqërisë
Ortakët zotërojnë kapitalin si më poshtë:
 - **Geri Lulaj** – 100 % 10,000 (dhjetë mijë) Lekë
2. Kuotat janë të zakonshme dhe secili ortak ka të drejta votimi *proporcionale* me vlerën nominale të çdo kuote.
3. Kapitali i Shoqërisë paguhet plotësisht dhe nënshkruhet nga Ortakët Themelues.

V. Administratori

1. Shoqëria menaxhohet nga 1 (një) Administrator i cili është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe e përfaqëson atë te çdo pale e tretë. Numri i Administratorëve mund të ndryshohet nga Asambleja e Përgjithshme .
2. Administratori do të jetë përgjegjës për punët e përditshme të Shoqërisë, duke iu nënshtruar kufizimeve të parashikuara në Statut, ligjin e aplikueshëm dhe nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar dhe mund të riemërohet. Administratori i parë i Shoqërisë është:
 - **Geri Lulaj, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë, më 31.01.1997, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. Personal J70131076S.**

Akti i Themelimit është bartuar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Akti i Themelimit është bartuar në pajtim me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Ortaku I Vetëm Themelues

Geri Lulaj
